

VENDIM
Nr. 66, datë 12.4.2024

MBI HEQJEN E PEZULLIMIT TË VENDOSUR ME VENDIMIN NR. 309, DATË 30.10.2023, “MBI PEZULLIMIN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S, NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “ECO-ELB” SHA PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, DHE RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ECO-ELB” SHA, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a” dhe 38 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenin 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 645/4 prot., datë 9.4.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 309, datë 30.10.2023, ‘Mbi pezullimin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë ‘ECO-ELB’ sh.a. për rinovimin e licencës së në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike’, dhe rinovimin e licencës së shoqërisë ‘ECO-ELB’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 309, datë 30.10.2023, vendosi të pezullojë vendimarrjen për aplikimin e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kw, derisa shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për përdorimin e impiantit të incenerimit për prodhimin e energjisë elektrike, brenda datës 27.3.2024.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimarrje me shkresën nr. 137/20 prot., datë 31.10.2023, dhe me shkresën nr. 645 prot., datë 16.2.2024, i është kujtuar plotësimi i këtij dokumenti brenda afatit të përcaktuar në vendim.

- Me *e-mail*-in e datës 29.1.2024 dhe shkresën e protokolluar në ERE me nr. 645/3 prot., datë 4.4.2024, shoqëria ka depozituar në ERE kontratën e qirasë nr. 1111 prot., datë 28.3.2024, nënshkruar mes Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (në cilësinë e qiradhënësit) dhe shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. (në cilësinë e qiramarrësit) me afat nga 28.3.2024 deri më 27.3.2025. Po ashtu, shoqëria ka bërë me dije se turbina nuk ka qenë dhe vazhdon të mos jetë në gjendje pune.

- Me depozitimin e kontratës së qirasë si më sipër rezulton se nuk ekziston më kushti pezullues i vendimit të nr. 309/2023, e në të tilla rrethana vlerësohet të vijohet me heqjen e këtij pezullimi dhe marrjen e vendimit përfundimtar, në lidhje me rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kw.

- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por afati i kontratës së

qirasë të nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (në cilësinë e qiradhënësit) dhe shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. (në cilësinë e qiramarrësit) ka afat vlefshmërie deri më 27.3.2025. Në këto rrethana, ERE kushtëzohet nga ky afat për sa i përket afatit të vlefshmërisë që do të ketë ky rinovim licence, pra deri më 27.3.2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Heqjen e pezullimit të vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. të vendosur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 309, datë 30.10.2023.

2. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kw, me afat deri më 27.3.2025.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “ECO-ELB” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi